



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 291/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës dega në Rahovec, përshkak se Nusret Shala në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 1603a/01D, i ka detyruar votuesit që të votojnë për subjekti që preferonte dhe pashkak të manipulimit të nënshkrimeve, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet poshtë ankesa si e pasafatshme

A R S Y E T I M I

Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës dega në Rahovec, ka parashtruar një ankesë më të cilën pretendon se Nusret Shala në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 1603a/01D, në fshatin Zaqisht komuna e Rahovecit, ka bërë shkelje të rregullave dhe proceduarve të votimit duke detyruar votuesit që të përcaktohen për të votuar subjektin që ai e preferonte. Sipas parashtruesit të ankesës kryesuesi i VV pas mbylljes së VV është vonuar në numërimin e votave, arsyeja ka qenë se nuk i ka lejuar vëzhguesit e PDK-së të jenë të pranishëm gjatë numërimit të votave në këtë vendvotim. Për këtë arsye numërimi i votave ka filluar me vonesë prej një ore respektivisht në ora 20:00. Poashtu parashtruesi i ankesës potencion se ka pas manipulim të votave dhe nënshkrimeve sepse gjatë pranimin të materialit senzitiv është konstatuar që:

- Kutia nga kjo QV ka pasur shiritat mbyllës që ka qenë i ndërruar numri identifikues i të cilëve nuk përputhen i atyre të materialit senzitiv dhe njeri prej këtyre shiritave të domosdoshëm ka munguar tërësisht.
- FPR-së i mungon fleta e parë e punës dhe në FRP ka pasur ndërhyrje.
- Në kuti të votimit mungon libri i nënshkrimeve.

F A K T E T

Më 23 Nëntor 2010, në ora 18:00, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka pranuar një ankesë nga Subjektit politik PDK dega në Rahovec, me pretendim se ka pas ndërhyrje nga kryesuesi i VV 1603a/01D që ti detyroj votuesit të votojnë për personin që ai preferonte si dhe përshkak të manipulimit të votave dhe nënshkrimeve.

Parashtruesi i ankesës propozon që të anulohet rezultati i votimit në VV 1603/01D për shkak të shkeljeve të LZP-së.

ANALIZË

Juridiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* Ligji Nr. 03/L- 072.

Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së

Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes një ankesë pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga koha kur është parashtruar ankesa.

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se ankesa është e pasafatshme, sepse ankesa në PZAP është pranuar pas shtatëdhjetenjë (71) orëve, të mbylljes së Qendrës së Votimit ndërsa afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
A nr. 291/2010 më datën 24.11.2010.

